

VENDIM
Nr. 898 , datë 29.12.2022

**PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË MENJËHERSHME TË PUNONJËSVE
TË NJËSIVE TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME DHE INSTITUCIONEVE TË
ARSIMIT TË LARTË PUBLIK PËR ZBUTJEN E IMPAKTIT TË KRIZËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbështetjen financiare të menjëhershme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik (IALP) për zbutjen e impaktit të krizës.

2. Në kuptim të këtij vendimi, njësi të qeverisjes së përgjithshme janë tërësia e njësive të qeverisjes qendrore, vetëqeverisjes vendore dhe të fondeve speciale.

3. Masat e mbështetjes financiare të menjëhershme jepen, si më poshtë vijon:

a) Në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë, ku përfshihen punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe IALP-ve, me pagë bruto nën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, si dhe kategoritë e mëposhtme:

i. punonjësit e policisë në strukturat e RENEA-s, FNSH-së, DELTA-s dhe të strukturës së posaçme operacionale;

ii. punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit;

iii. punonjësit e strukturës së Batalionit të Këmbësisë së Lehtë.

b) Në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, ku përfshihen punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe IALP-ve, me pagë bruto mbi 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

4. Përfshihen nga përcaktimet e pikës 3 institucionet e rivlerësimit kalimtar të magistratëve, efektet financiare të të cilëve përballohen brenda buxhetit të miratuar për këto institucione, për vitin 2022.

5. Nga kjo mbështetje financiare e menjëhershme përjashtohen stafet politike dhe personat e zgjedhur të qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore.

6. Efektet financiare të pikës 1, të këtij vendimi, përballohen, si më poshtë vijon:

a) për çdo njësi të qeverisjes qendrore, për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit dhe punonjësit arsimorë/edukatorë të transferuar nga pushteti qendror në pushtetin vendor nga shpenzimet korrente, të miratuara për çdo njësi në buxhetin e vitit 2022, si dhe nga fondit rezervë i buxhetit, për vitin 2022;

b) për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga shpenzimet korrente, të miratuara në buxhetet përkatëse, për vitin 2022;

c) për njësitë e fondeve speciale nga shpenzimet korrente, të miratuara në buxhetin përkatës, për vitin 2022;

ç) për IALP-të nga buxhetet përkatëse, për vitin 2022.

7. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për shpërndarjen e fondeve të nevojshme nga fondit rezervë i buxhetit, për vitin 2022, për të përballuar efektet financiare për institucionet e përfshira në shkronjën “a”, të pikës 6, të këtij vendimi, në rast se fondit nga shpenzimet korrente në dispozicion nuk është i mjaftueshëm.

8. Ngarkohen njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe IALP-të të kryejnë veprimet financiare, deri më datë 10 janar 2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku